
SAT School Day Paper Test Directions Essay

Standard Time Script

Notes to the Proctor

Using this document on test day:

Distribute this document once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book. Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period. Students may **not** be given additional time, unless approved by College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

Shënime për studentin

Në vijim është përkthimi i udhëzimeve që kujdestari juaj do t'i lexojë me zë, si dhe udhëzimeve të shkruara që gjenden në librat e testit tuaj. Përcillni udhëzimet derisa kujdestari juaj i lexon ato me zë në anglisht. Nëse keni pyetje rreth asaj se çfarë është duke lexuar kujdestari juaj, ju lutem ngrisni dorën.

- Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përshtaten fjalë për fjalë me atë që lexon kujdestari juaj; megjithatë informatat e rëndësishme janë të njëjta.
- Kujdestari juaj mund të kapërcejë disa udhëzime që nuk vlejné për situatën tuaj të testimit.
- Mund ta mbani këtë dokument në tavolinë gjatë gjithë kohës së testimit por duhet t'ia ktheni kujdestarit tuaj pas testimit.
- MOS e përdorni këtë dokument për letër planifikimit të përgjigjes.
- Në kohë të ndryshme, kujdestari juaj do të lajmërojë sa është koha e mbetur për pjesën, si dhe për pauzat kur të jetë e përshtatshme. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, këto lajmërime mund të dallojnë sa i përket kohës dhe pazave të listuara në këtë dokument të përkthyer. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj.
- Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, kujdestari i juaj mund të ju jep udhëzime shtesë në gjuhën angleze.
- Ikonat përdoren për gjatë tërë këtij dokumenti për të ju tërhequr vëmendjen në informata specifike:



Informata e rëndësishme.



Udhëzimet që përmban libri juaj i testimit

I gjithë teksti i hijezuar tregon udhëzimet e thëna nga kujdestari juaj.

Përmbajtja

Notes to the Proctor 1

Shënime për studentin 2

Mirë se vini në Testim 4

Rregullat dhe pasojat e testimit 4

Konfirmimi që pajisjet personale janë fikur 5

Përgatitni Bankat për Testim 5

Kontrolloni artikujt në tavolinat e punës 5

Shpërndarja e materialeve të testimit 5

Udhëzimet e kujdestarit për Paper Test Taker Administration Instructions 6

Rezultatet e Dorëzuara në Seksionin e Telefonit 6

Njoftimi për privatësisë dhe pyetje opsionale 7

Prezantimi i Programit të Lidhjeve 7

Përzgjedhja e institucioneve për Dërgim falas të rezultateve SAT 7

Zotimi i Sigurisë së Testit dhe Përfundimi 8

Udhëzime shtesë të testimit 8

Pikat përfundimtare para testimit 9

Udhëzimet në kopertinën e pasme 10

Filloni testimin 11

Seksioni leximi dhe shkrimi: Moduli 1 11

Udhëzimet e Modullit 1 të Leximit dhe Shkrimit 11

Gjatë Modullit 11

Seksioni leximi dhe shkrimi: Moduli 2 12

Udhëzimet e Modullit 2 të Leximit dhe Shkrimit 12

Gjatë Modullit 12

Pas Modullit 2 12

Seksioni i matematikës: Moduli 1 13

Udhëzimet e Modullit 1 të Matematikës 14

Gjatë Modullit 15

Seksioni i matematikës: Moduli 2 15

Udhëzimet e Modullit 2 të Matematikës 16

Gjatë Modullit 17

Pas Modullit 2 18

Seksioni i SAT Esesë 18

Para Esesë 18

Shpërndarja e materialeve të Esesë 18

Koha për Ese 19

Lirimi 21

Para lirim të studentëve 21

1 Mirë se vini në Testim

Kur të jeni gati për të filluar, kujdestari juaj do të thotë:

Mirëmëngjesi. Siç e dini, jeni këtu për t'iu nënshtruar SAT. Urime për marrjen e këtij hapi të rëndësishëm drejt kolegjit dhe synimeve në karrierë.

Para se të filloni testin, unë do të lexoj disa udhëzime dhe do t'ju shpërndaj disa libreza me informata që t'i rishikoni dhe plotësoni. Kjo do të zgjasë rreth 30 minuta. Ju lutem dëgjoni me kujdes dhe ngriteni dorën nëse keni ndonjë pyetje. Mbani mend, roli im është të sigurohem që keni mundësinë më të mirë për të demonstruar shkathtësitë dhe njohuritë tuaja.

1.1 Rregullat dhe pasojat e testimit

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

College Board SAT Rregullat e testimit përfshijnë rregullat dhe politikat për të siguruar që të gjithë studentët të kenë një përvojë testuese të drejtë dhe të barabartë. Të gjithë ne në këtë klasë sot jemi përgjegjës për të ndihmuar që kjo të ndodhë. Nëse ndokush shqetëson të tjerët ose përpiqet të fitojë avantazh të padrejtë, do t'i kërkojë të largohet nga klasa dhe rezultatet e tyre do të anulohen. Atyre gjithashtu mund t'u ndalohet t'u nënshtrohen testeve tjera të College Board në të ardhmen.

Kujdestari juaj do të listojë shembuj të shkeljes së rregullave duke thënë:

Këtu kemi disa shembuj të avantazheve të padrejta:

- Dhënia, përpjekja për të dhënë ose marrë ndihmë të çdo lloji
- Shikimi i librit të testit para se të fillojë koha
- Shikimi në cilindo modul përveç atij në të cilën gjendemi tani
- Shënjimi ose ndryshimi i përgjigjeve pas përfundimit të kohës
- Tentativa për të larguar materiale të testit nga klasa e testimit
- Posedimi i celularit ose çfarëdo ndihme tjetër të paautorizuar për testin gjatë testimit ose gjatë pauzave
- Posedimi i çelësit të përgjigjeve ose ndarja e përgjigjeve me këdo gjatë ose pas testit
- Shkuarja te dollapi me dry ose largimi nga ndërtesa gjatë testit, përfshirë edhe gjatë pauzës
- Tentimi për t'iu nënshtruar testit për dikë tjetër
- Ngrënia ose pirja gjatë testimit pa akomodim të miratuar për të bërë këtë
- Shkaktim shqetësimi
- Mosndjekja e procedurave të testimit

Këto politika ndihmojnë që të sigurohet se përvoja e testimit tuaj sot të jetë e drejtë dhe se mund të fokusoheni në testin tuaj pa shpërqëndrime.

Nëse shihni ndonjë gjë që ju brengos, ju lutem bisedoni me mua ose ndonjë anëtar tjetër të personelit pas testit dhe ne do t'ju ndihmojmë lidhur me hapat e radhës.

A ka ndonjë pyetje për ndonjë gjë që kam thënë deri tani?

1.2 Konfirmoni që pajisjet personale janë fikur

Më pas, kujdestari juaj do të thotë:

Ne duhet të sigurohemi që të gjitha pajisjet elektronike të jenë të fikura. Këtu përfshihen telefonat, orët me alarm, orët inteligjente, tabletët, kompjuterët ose çdo pajisje tjetër elektronike.

Nëse tashmë e keni dorëzuar një pajisje dhe nuk jeni të sigurt nëse e keni fikur, ngrini dorën dhe unë do t'ju lejoj të kontrolloni për së dyti nëse është e fikur.

Kujdestari juaj do t'u kujtojë studentëve rregullën e pajisjeve elektronike duke thënë:

Nëse dikush ka një telefon ose pajisje tjetër që bën zhurmë, edhe nëse është marrë, ose nëse dikush hyn në ndonjë pajisje të ndaluar në çdo kohë, duke përfshirë edhe gjatë pushimeve, unë do të kërkoj që ata të largohen. Rezultatet e tyre do të anulohen dhe pajisja e tyre mund të konfiskohet. Kjo mund të jetë shumë shpërqendruese, ndaj ju lutemi, jini të vëmendshëm ndaj studentëve të tjerë në klasë dhe mendoni me kujdes për çdo pajisje që keni sjellë sot. Ngrini dorën nëse keni ende një pajisje me vete në bankën tuaj. Këto duhet të fikën, me alarme të çaktivizuara dhe të ruhen larg nga bankat tuaja. Ato do të kthehen në fund të testit.

1.3 Përgatitni Bankat për Testim

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Faleminderit që u kushtuat vëmendje këtyre udhëzimeve. Tani, ju do t'i pastroni tavolinat për testim.

Nëse keni sjellë me vete bateri shtesë, pije, ose zamra, vendosni në dyshe me nën tavolinë.

Në bankën tuaj, duhet të keni lapsat, kalkulatorin e pranueshëm dhe kalkulatorin rezervë, nëse i keni sjellë ato, si dhe çdo mjet ndihmës testimi që është miratuar ta përdorni si mjet ndihmës. Ju lutem hiqni çdo send tjetër nga banka juaj dhe vendosini në çantat tuaja në pjesën e përparme ose anësore të klasës.

Pasi që bankat të jenë pastruar nga gjësendet e ndaluara, kujdestari juaj do të thotë:

Faleminderit. Tani për disa momente do të kontrolloj përreth dhe të sigurohem se të gjithë ju jeni duke përdorur kalkulatorë të pranueshëm.

1.4 Kontrolloni artikujt në tavolinat e punës

Pasi që kujdestari ti aprovoj të gjitha pajisjet, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem mbani mend se nuk mund të ndani ose shkëmbeni kalkulatorët në asnjë moment. Vendosni kalkulatorin dhe çdo kalkulator tuaj rezervë nën tryezën tuaj tani. Nuk do t'ju duhet një kalkulator për seksionin e parë të testit.

1.5 Shpërndarja e materialeve të testimit

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do t'i jap një libër testimi secilit prej jush. Mos e hapni akoma.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Kthehuni në pjesën e pasme të librit tuaj të testimit dhe shënoni mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni një të tillë. Më pas shkruani kodin 6-shifror të kësaj shkolle [kujdestari juaj do t'ju japë kodin], emrin e shkollës dhe numrin (ose emrin) e kësaj salle.

1.6 Udhëzimet e kujdestarit për Paper Test Taker Administration Instructions

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do ta shpërndaj një kopje të Paper Test Taker Administration Instructions (Udhëzimeve për administrimin e vijuesve të testit në letër) për secilin prej jush.

Për të shpjeguar broshurën, kujdestari juaj do të thotë:

Testi që do të bëni është një format letre i atij digjital SAT. Ka informata ku studentët japin dhe marrin në Bluebook™, aplikacionin e testimit digjital, të cilin gjithashtu duhet ta shikoni dhe të përgjigjeni në te. Broshurën që sapo e dhashë përmban atë informacion.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Përgjigjet tuaja siç janë shënuar në librin tuaj të testimit do të transkriptohen në Bluebook pasi të keni mbaruar testimin. Bordi i Kolegjit ka nevojë që edhe testuesit edhe personeli të verifikojnë miratimin për këtë transkriptim dhe që përgjigjet e transkriptuara të pasqyrojnë përgjigjet autentike të testuesit tuaj ndaj pyetjeve të testit. Hapni broshurën tuaj në faqen 3 dhe lexoni pjesën "Studenti Filloni Këtu". Ndiqni udhëzimet, të cilat përfshijnë plotësimin e disa informatave në kopertinën e përparmë. Ngrini dorën nëse keni nevojë për ndihmë për të gjetur ndonjë nga informacionet e kërkuara. Kur të keni mbaruar, leni poshtë lapsin ose stilolapsin tuaj dhe shikoni lart.

Kujdestari juaj do ta shqyrtojë përmbajtjen e broshurës me ju duke thënë:

Tani kthehuni në faqen 3. Te "Complete Your Info" ("Plotësoni informacionin tuaj") do të shihni një listë të gjërave për t'u rishikuar dhe konfirmuar në këtë librezë. Bordi i Kolegjit ka nevojë që ju të rishikoni deklaratën e tyre të privatësisë dhe rregullat e testimit dhe të pajtoheni me to para se filloni testin. Së pari do të shihni "Use of the Bluebook App" ("Përdorni Aplikacionin"). Ky seksion shpjegon se si përdoren të dhëna të caktuara të mbledhura në aplikacionin Bluebook dhe kujt mund t'i zbulohen. Ju duhet të pajtoheni me këto përdorime në mënyrë që përgjigjet tuaja të transkriptohen në fund të testit.

Pasi të keni shënuar kutinë në faqen 4 që pajtoheni me politikën e aplikacionit Bluebook, do të keni rreth 15 minuta për ta lexuar dhe për tu pajtuar me Testing Rules and the Privacy Statement (Rregullat e testimit dhe Deklaratën e Privatësisë). Kur të arrini te titulli "Indicate Your Acceptance of Testing Rules" ("Tregoni që pranoni rregullat e testimit") ju lutemi shënjoni kutinë pranë "I have read and I accept these rules" ("Unë i kam lexuar dhe i pranoj këto rregulla"). Pastaj leni poshtë lapsin ose stilolapsin tuaj dhe shikoni lart. Nëse në çdo kohë keni një pyetje, ju lutemi ngrini dorën.

1.6.1 Rezultatet e Dorëzuara në Seksionin e Telefonit

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Seksioni i radhës shpjegon një aplikacion të ri të telefonit mobil që ju lejon të shikoni rezultatet tuaja përmes telefonit tuaj. Ju gjithashtu mund ti pranoni burimet e kolegjit dhe karrierës. Ju lutemi lexoni informatat rreth BigFuture School. Nëse dëshironi të qaseni në të, ju lutemi ofroni numrin tuaj mobil. Numri i telefonit mobil që jepni duhet të jetë një numër i SHBA-ve. Jepni një email adresë rikuperimi për të lejuar College Board të zgjidhë çdo problem që keni me qasjen në aplikacion.

Kur të keni mbaruar me këtë faqe, ju lutem leni poshtë lapsin ose stilolapsin tuaj dhe shikoni lart.

1.6.2 Njoftimi për privatësisë dhe pyetje opsionale

Kur të gjithë studentët të jenë gati kujdestari juaj do të thotë:

Para se të filloni të jepni informata, ju lutemi lexoni informacionin nën titull "Privacy Notice" ("Njoftimi i privatësisë"). Ky Njoftim i Privatësisë përshkruan se si College Board mund të përdorë informatat që ju mund të zgjidhni ti jepni dhe kujt mund t'i zbulohen." Ky Njoftim i Privatësisë përshkruan se si College Board mund të përdorë informatat që ju mund të zgjidhni ti jepni dhe kujt mund t'i zbulohen. Nëse vendosni t'u përgjigjeni pyetjeve opsionale, ktheni faqen dhe filloni. Do të shihni pyetje e shënjuara "Your Contact Info" ("Të dhënat tuaja të kontaktit"), "Tell Us About Yourself" ("Na trego rreth vetes"), "What Are Your Academic Goals" ("Cilat janë qëllimet tuaja akademike"), dhe "Tell Us About Your Family" ("Na tregoni për familjen tuaj"). Ju gjithashtu do të shihni shënime se përse College Board kërkon këtë informacion dhe se si do ta përdorin atë specifikisht për secilën kategori të pyetjeve. Të gjitha pyetjet janë opsionale.

Kur të keni përfunduar, ju lutem leni poshtë lapsin ose stilolapsin tuaj dhe shikoni lart.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem ktheni faqen tjetër.

1.6.3 Prezantimi i Programit të Lidhjeve

Nëse studentët në shkollën ose zonën tuaj kanë të drejtë të marrin pjesë në një mundësi të re të quajtur "Lidhjet", kujdestari juaj do të lexojë skriptin në vijim. Përndryshe, ata do të shkojnë përpara te seksioni Përzgjedhja e institucioneve për Dërgim falas të rezultateve SAT më poshtë në këtë faqe.

Kujdestari juaj do të kthehet te faqja Prezantimi i Lidhjeve duke thënë:

Tani kthejeni faqen dhe lexoni për një program të ri të ofruar nga College Board i quajtur Connections (Lidhjet). Lexoni për qëllimin e programit dhe si funksionon ai. Nëse dëshironi të merrni pjesë, vendosni një shenjë në kutinë në këtë faqe. Keni parasysh se pjesëmarrja është vullnetare dhe mund të tërhiqeni në çdo kohë. "

1.6.4 Përzgjedhja e institucioneve për Dërgim falas të rezultateve SAT

Kujdestari juaj do ta prezantojë Dërgim falas të rezultateve SAT duke thënë:

Kur vijoni SAT, mund të zgjidhni deri në katër kolegje ose programe bursash për të dërguar rezultatin tuaj falas. Ju lutemi lexoni për këtë mundësi. Derisa jeni duke lexuar për të, unë do t'i jap çdonjërit nga prej jush një broshurë ku janë shënuar

emrat e institucioneve që mund ti zgjidhni për t'i dërguar rezultatet tuaja. Ndiqni udhëzimet për përdorimin e kësaj broshure në faqen “Dërgimi falas i rezultateve tuaja SAT”.

Ky hap është opsional. Nëse nuk dëshironi të dërgoni rezultatet tuaja, ju lutemi uluni në heshtje derisa të tjerët të përfundojnë. Kur të keni përfunduar, vendosni *Score Sends Code List (Lista e Kodeve për Dërgim të Rezultateve)* broshurën nën bankën tuaj dhe shikoni lart.

Kujdestari juaj do ta japë një broshurë *Score Sends Code List (Lista e Kodeve për Dërgim të Rezultateve)* çdo studenti.

1.6.5 **Zotimi i Sigurisë së Testit dhe Përfundimi**

Për t'i drejtuar studentët në plotësimin e zotimit të sigurisë së testit, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutemi lexoni tre rregullat që vlejné për testin që do të bëni. Për të dëshmuar pajtimin tuaj me këto rregulla, shkruani me dorë zotimin e sigurisë së testit të dhënë më poshtë me listën e rregullave. Kur të keni mbaruar, ju lutem leni poshtë lapsin ose stilolapsin tuaj dhe shikoni lart.

Kujdestari juaj do të përfundojë duke thënë:

Pothuajse kemi mbaruar me këtë librezë. Ju lutemi kthehuni në pjesën e pasme të librit tuaj të testit dhe shtoni ose konfirmoni katër pjesët e informacionit të shënuara më poshtë “Confirm Your Info on Your Test Book” (“Konfirmoni informacionin tuaj në librin tuaj të testimit”). Ky informacion do të ndihmojë Bordin e Kolegjit të krahasoj librin tuaj të testimit dhe përgjigjet me transkriptin tuaj. Kur të keni mbaruar, ju lutem leni poshtë lapsin tuaj dhe shikoni lart.

Kur të gjithë studentët të kenë plotësuar faqen, kujdestari juaj do të thotë:

Faleminderit për plotësimin e këtij informacioni. Ju lutemi mbyllni librezën tuaj dhe vendoseni nën tryezën tuaj.

1.7 **Udhëzime shtesë të testimit**

kujdestari juaj mund t'ju lexojë udhëzime shtesë testimi për ju ose personelin mbështetës. Përndryshe, ata do të kalojnë përpara në Pikat Përfundimtare Para Testimit.

Kujdestari juaj mund ti lexojë udhëzimet nga ky seksion nëse ato aplikohen. Më pas ata do të vazhdojnë te Pikat Përfundimtare Para Testimit, më poshtë.

Për një lexues njerëzor (human reader), kujdestari juaj do të thotë:

Është e rëndësishme të lexoni vetëm atë që është në skript. Mos jepni shtjellime përtej asaj që është në skript, edhe nëse studenti e kërkon atë. Nëse studenti miratohet për vizatime me vija të ngritura, mund ta ndihmoni një student që nuk lexon braille të interpretoj etiketat dhe numrat që shoqërojnë vizatimet me vija të ngritura. Etiketat dhe numrat e dhënë me shifra mund të gjenden në lokacionet përkatëse në librat e testit me printime të rregullta dhe printime të mëdha. A keni ndonjë pyetje në lidhje me procedurat?

Për një shkruar/scribe, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem ndiqni këto udhëzime:

Ju duhet të shkruani vetëm atë që studenti dikton. Ju nuk duhet ta drejtoni studentin në mënyrë që do të rezultonte në një përgjigje të ndryshme

Për një student që përdor shkruar/scribe, kujdestari juaj do të thotë:

Përgjigjet tuaja dhe çfarëdo korigjimi do të regjistrohen ndërsa ju i diktoni ato. Nëse dëshironi të rishikoni punën tuaj, përgjigjet tuaja do të ju lexohen. A keni ndonjë pyetje?

Për një student që përdor braille me formatin e vijave të ngritura, kujdestari juaj do të thotë:

Testi braille është i ndarë në disa libra. Do t'ju jepet 1 libër në të njëjtën kohë. Gjatë gjithë testit, çdo pyetje ndahet nga një tjetër me një vijë. Çdo pyetje fillon në celulën 1, me shënimet (runovers) që fillojnë në qelizën 5. Çdo zgjedhje e përgjigjes fillon në celulën 3, me shënimet (runovers) që fillojnë në celulën 5.

Braille është në Angleze të Unifikuar Braille (Unified English Braille - UEB). Modulet e matematikës janë në Kodin Nemeth të rishikuar në vitin 1972. Libri i referencës së matematikës braille përmban formula dhe udhëzime matematikore për përdorim me të gjitha seksionet e matematikës. Testi juaj përfshin vizatime me vijë të ngritur të grafikëve dhe figurave të përdorura në test. Modulet Leximi dhe Shkrimi janë në alfabetin e rregullt braille të klasës së dytë. A keni ndonjë pyetje në lidhje me procedurat?

1.8 Pikat përfundimtare para testimit

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Testin do ta filloni pas pak minutave, pasi të lexoj edhe disa pika përfundimtare.

Gjatë testit, mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Nëse gjeni një defekt, ngrini dorën dhe unë do të vij te ju.

Pastaj, kujdestari juaj do të thotë:

Ka 2 seksione testimi ku secili përbëhet nga 2 module. Testi është në kohë sipas modulit. Do të postoj kohët e fillimit dhe të mbarimit për çdo modul me kohë këtu [*kujdestari juaj do të tregojë se ku do të postohet ky informacion*], dhe do të njoftoj kur të mbeten 5 minuta në secilin modul.

Unë do të ec nëpër klasë kohë pas kohe për t'u siguruar se të gjithë janë duke punuar në modulin e saktë. Për këtë test, ju mund të punoni vetëm në 1 modul në të njëjtën kohë. Kjo mund të jetë ndryshe nga sa jeni mësuar, kështu që sigurohuni të mos ecni përpara ose të mos shikoni prapa në librin e testit edhe nëse e përfundoni modulin e tanishëm.

Pasi të përfundojë testi, ju lutem qëndroni ulur dhe mos u largoni nga klasa derisa të ju liroj.

Nëse keni ndonjë pyetje përfundimtare mund ta bëni tani.

1.9 Udhëzimet në kopertinën e pasme



Në vijim është përkthimi i ballinës së librit të testit. Kur të udhëzoheni, duhet të shkruani në librin tuaj të testit, jo në këtë dokument.

Emri juaj (Me shkronja të shtypit)	_____	_____	_____	_____
	MBIEMRI	EMRI	INICIALI I MESËM	
Qendra e testimit / Shkolla	_____	_____	_____	_____
	NUMRI I SHKOLLËS	EMRI I SHKOLLËS	NUMRI / EMRI I KLASËS SË TESTIMIT	

SAT School Day (Dita e Shkollës)

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Mund të punoni në vetëm një modul në të njëjtën kohë.
- Nëse përfundoni një modul para përfundimit të kohës, kontrolloni punën tuaj vetëm në atë modul. NUK mund të kaloni në ndonjë modul tjetër.

SHËNIMI I PËRGJIGJEVE TUAJA

- Sigurohuni që t'u përgjigjeni pyetjeve tuaja siç duhet në këtë libër.
- Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

PËRDORIMI I LIBRIT TUAJ TË TESTIT

- Ju mund të përdorni librin e testit për punë të shënimeve/kalkulimeve tuaja.
- Nuk duhet të palosni apo largoni faqe apo pjesë të faqeve nga ky libër, ose të merrni librin nga klasa e testimit.

SIGURIA E TESTIT

Ju jeni të detyruar nga rregullat në vijim për testin e sotëm:

- Ju nuk mund të jepni ose pranoni ndihmë gjatë testit. Ju nuk mund të ndani ose postoni asgjë në lidhje me këtë test.
- Përgjigjet tuaja duhet të jenë tërësisht tuajat. College Board do ti shqyrtojë përgjigjet tuaja.
- Nëse përpiqeni të mashtroni, rezultatet tuaja do të anulohen, zyrat e pranimeve në kolegji mund të njoftohen dhe do të skualifikoheni nga marrja e çdo AP[®], SAT[®], ose CLEP[®] provimet.

MARRËVESHJA E STUDENTIT

Në mënyrë që testi juaj të vlerësohet, duhet të lexoni deklaratën në vijim, të bëni një kontroll pranë "I agree" ("Pajtohem"), dhe nënshkruani emrin tënd.

Unë jam personi që duhet ti nënshtrohet këtij testi. Pajtohem të ndjek rregullat e mësipërme dhe kuptoj se çfarë do të ndodhë nëse i shkel ato.

Pajtohem


Nënshkrimi im: _____

Idetë që përmbajnë pasazhet për këtë test, disa nga të cilat janë nxjerrë ose përshtatur nga materialet e publikuara, nuk i paraqesin domosdo mendimet e College Board.

MOS E HAPNI KËTË LIBËR DERISA KUJDESTARI TË JU THOTË TA BËNI KËTË.

2 Filloni testimin

2.1 Seksioni leximi dhe shkrimi: Moduli 1

 Koha standarde për modul është **39 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Ne do të fillojmë testimin me modulin e parë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Pasi të fillojmë, do të keni 39 minuta për të punuar në Modulin 1. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit dhe do t'ju njoftoj kur 5 minuta kanë mbetur.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Rrethoni shkronjën e përgjigjes suaj të zgjedhur në librin tuaj të testit. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Përgjigjet e shumëfishta të rrethuara për 1 pyetje do të llogariten si përgjigje e pasaktë. Nëse kapërceni një pyetje, sigurohuni që të lini kohë të mjaftueshme për t'u kthyer tek ajo më vonë. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.


Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i parë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Fat të mbarë, të gjithë.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.1.1 Udhëzimet e Moduli 1 të Leximit dhe Shkrimit

 Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 1 të Leximit dhe Shkrimit.

33 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të të lexuarit dhe të shkruarit. Çdo pyetje përfshin një ose më shumë hyrje, të cilat mund të përfshijnë një tabelë ose grafik. Lexoni me kujdes çdo hyrje dhe pyetje, dhe më pas zgjidhni përgjigjen më të mirë për pyetjen bazuar në hyrjen(t).

Të gjitha pyetjet në këtë seksion janë me zgjedhje të shumëfishta me zgjedhje prej katër përgjigjeve. Çdo pyetje ka një përgjigje të vetme më të mirë.

2.1.2 Gjatë Moduli

Pas 34 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 1.

Pas saktësisht 39 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.2 Seksioni leximi dhe shkrimi: Moduli 2



Koha standarde për modul është **39 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Do të vazhdojmë testimin me modulin e dytë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Pasi të fillojmë, do të keni 39 minuta për të punuar në Modulin 2. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit dhe do t'ju njoftoj kur 5 minuta kanë mbetur.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Rrethoni shkronjën e përgjigjes suaj të zgjedhur në librin tuaj të testit. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Përgjigjet e shumëfishta të rrethuara për 1 pyetje do të llogariten si përgjigje e pasaktë. Nëse kapërceni një pyetje, sigurohuni që të lini kohë të mjaftueshme për t'u kthyer tek ajo më vonë. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit në modulin e dytë të seksionit të Leximit dhe Shkrimit. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.2.1 Udhëzimet e Moduli 2 të Leximit dhe Shkrimit



Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 2 të Leximit dhe Shkrimit.

33 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të të lexuarit dhe të shkruarit. Çdo pyetje përfshin një ose më shumë hyrje, të cilat mund të përfshijnë një tabelë ose grafik. Lexoni me kujdes çdo hyrje dhe pyetje, dhe më pas zgjidhni përgjigjen më të mirë për pyetjen bazuar në hyrjen(t).

Të gjitha pyetjet në këtë seksion janë me zgjedhje të shumëfishta me zgjedhje prej katër përgjigjeve. Çdo pyetje ka një përgjigje të vetme më të mirë.

2.2.2 Gjatë Moduli 2

Pas 34 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 2.

Pas saktësisht 39 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.2.3 Pas Moduli 2

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

Për pauzë, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ndalemi për një pauzë 10 minuta. Ju lutem dëgjoni me kujdes këto rregulla:

- Mos i diskutoni pyetjet e testit me askënd ose mos iu qasni asnjë lloji të pajisjeve elektronike gjatë këtij pushimi ose cilitdo pushimi tjetër gjatë testit.
- Nëse keni nevojë të largoheni nga klasa, shkoni vetëm në hapësirat e dedikuara, në korridor ose në banjo.
- Zamrat dhe pijet lejohen vetëm në zonat e destinuara.
- Ju lutem kini konsideratë për studentët që janë duke punuar në klasat tjera dhe mos flisni në korridor.

Do të fillojmë përsëri pas saktësisht 10 minutave.

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj. Mos e hapni asnjë pjesë të testit deri sa të ju them unë.

2.3 Seksioni i matematikës: Moduli 1



Koha standarde për modul është **43 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Ne do të vazhdojmë testimin me modulin e parë të seksionit të Matematikës. Pasi të fillojmë, do të keni 43 minuta për të punuar në Modulin 1. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit dhe do t'ju njoftoj kur 5 minuta kanë mbetur.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Rrethoni shkronjën e përgjigjes suaj të zgjedhur në librin tuaj të testit. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Përgjigjet e shumëfishta të rrethuara për 1 pyetje do të llogariten si përgjigje e pasaktë. Nëse kapërceni një pyetje, sigurohuni që të lini kohë të mjaftueshme për t'u kthyer tek ajo më vonë. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të shumëfishtë, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Udhëzimet për plotësimin e përgjigjeve tuaja në këto pyetje janë në librin e testit. Ju do të shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen e testit dhe do ta rrethoni qartë. Nuk do të merrni përfitime për asgjë të shkruar jashtë rrethit.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Për këtë modul mund ta përdorni kalkulatorin. Nëse keni kalkulator, ju lutem largoni mbulesën dhe vendoseni kalkulatorin në tavolinën tuaj tani. Mbani mbulesën e kalkulatorit në dysheme nën tavolinën tuaj gjatë testimit.

Edhe pse ju lejohet të përdorni kalkulator për këtë modul, mund të jepet përgjigje në të gjitha pyetjet pa kalkulator.

Nëse përdorni kalkulator, mbani mend të ndiqni këto udhëzime:

- Mbani kalkulatorin rrafsh në tavolinën tuaj ose mbajeni ashtu që studentët tjerë të mos mund të shohin punën tuaj.
- Mos e ndani apo shkëmbeni kalkulatorin tuaj.
- Nëse keni kalkulator rezervë apo bateri, mbani në dyshe në tavolinën tuaj.
- Nëse kalkulatori juaj nuk funksionin dhe keni bateri ose kalkulator rezervë, ngriteni dorën. Do të afrohem për të ju ndihmuar. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni testin dhe bëni më të mirën që mundeni.


Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i parë të seksionit të Matematikës. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.3.1 Udhëzimet e Moduli 1 të Matematikës

 Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimit për Modulin 1 të Matematikës.

27 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të matematikës.


Përdorimi i një kalkulatori lejohet për të gjitha pyetjet.

SHËNIME

Përveç nëse tregohet ndryshe:


- Të gjitha variablat dhe shprehjet paraqesin numra realë.
- Shifrat e dhëna vizatohen në shkallë.
- Të gjitha figurat shtrihen në një nivel/rrafsh.
- Domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA




$$A = \pi r^2$$


$$C = 2\pi r$$




$$A = l w$$




$$A = \frac{1}{2} b h$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndëshat e drejtë të veçantë




$$V = l w h$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3} \pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3} \pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3} l w h$$

Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

Për pyetje me zgjedhje të shumëfishta, zgjidhni çdo detyrë, zgjidhni përgjigjen e saktë nga zgjedhjet e dhëna dhe më pas rrethoni përgjigjen tuaj në këtë libër. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

Për pyetjet e përgjigjeve të prodhuara nga studentët, zgjidhni çdo detyrë dhe shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen në librin e testit siç përshkruhet në vijim.

- Pasi të keni shkruar përgjigjen tuaj, rrethoni atë qartë. Ju nuk do të merrni kredi për asgjë të shkruar jashtë rrethit, ose për ndonjë pyetje me më shumë se një përgjigje të rrethuar.
- Nëse gjeni **më shumë se një përgjigje të saktë**, shkruani dhe rrethoni vetëm një përgjigje.
- Përgjigja juaj mund të jetë deri në 5 karaktere për një **përgjigje** pozitive dhe deri në 6 karaktere (përfshirë shenjën negative) për një **përgjigje** negative, por jo më shumë.
- Nëse përgjigja juaj është një **thyes** që është shumë e gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkruani ekuivalentin dhjetor.
- Nëse përgjigja juaj është një **dhjetor** që është shumë i gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkurtoje atë ose rrumbullakojë në shifrën e katërt.
- Nëse përgjigja juaj është një **numër i përzier** (si p.sh. $3\frac{1}{2}$), shkruajeni atë si një thyesë e parregullt ($\frac{7}{2}$) ose ekuivalentin e saj dhjetor (3.5).
- Mos përfshini **simbolet** të tilla si një shenjë përqindjeje, presje ose shenjë dollari në përgjigjen tuaj të rrethuar.

2.3.2 Gjatë Modullit

Pas 38 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 1.

Pas saktësisht 43 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.4 Seksioni i matematikës: Moduli 2



Koha standarde për modul është **43 minuta**. Nëse jeni duke u testuar në një akomodim të miratuar, koha dhe pauzat mund të dallojnë. Ju lutemi dëgjoni me kujdes lajmërimet që lexohen nga kujdestari juaj. Përkthimi i udhëzimeve të testit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer të thëna me zë.

Kur të gjithë të jenë gati, kujdestari juaj do të thotë:

Ne do të vazhdojmë testimin me modulin e dytë të seksionit të Matematikës. Pasi të fillojmë, do të keni 43 minuta për të punuar në Modulin 2. Do të postoj kohët e fillimit dhe të ndalimit dhe do t'ju njoftoj kur 5 minuta kanë mbetur.

Mbani librin e testit rrafsh në tavolinën tuaj. Rrethoni shkronjën e përgjigjes suaj të zgjedhur në librin tuaj të testit. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Përgjigjet e shumëfishta të rrethuara për 1 pyetje do të llogariten si përgjigje e pasaktë. Nëse kapërceni një pyetje, sigurohuni që të lini kohë të mjaftueshme për t'u kthyer tek ajo më vonë. Nëse e ndryshoni përgjigjen tuaj, fshijeni sa më plotë që të jetë e mundur. Ju mund të përdorni librin tuaj të testit për të shkruar ushtrimet, por sigurohuni që të keni rrethuar qartë vetëm një përgjigje.

Shumica e pyetjeve janë me zgjedhje të shumëfishtë, por disa pyetje janë me përgjigje të prodhuara nga studentët. Ju do të shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen e testit dhe do ta rrethoni qartë. Nuk do të merrni përfitime për asgjë të shkruar jashtë rrethit.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Për këtë seksion mund të vazhdoni të përdorni kalkulatorin.

Nëse përfundoni para se të them se mbaroi koha, mund ta kontrolloni punën tuaj në këtë modul, por nuk mund të shkoni në asnjë modul tjetër të testit.

Tani, hapni librin tuaj të testit te moduli i dytë të seksionit të Matematikës. Lexoni udhëzimet dhe filloni punën.

Për të filluar testin, kujdestari juaj do të thotë:

Koha fillon tani.

2.4.1 Udhëzimet e Modullit 2 të Matematikës



Në vijim është një përkthim i udhëzimeve në librin tuaj të testimin për Modulin 2 të Matematikës.

27 PYETJET (KOHA STANDARDE)

UDHËZIMET

Pyetjet në këtë pjesë trajtojnë një sërë aftësish të rëndësishme të matematikës.


Përdorimi i një kalkulatori lejohet për të gjitha pyetjet.

SHËNIME

Përveç nëse tregohet ndryshe:

- Të gjitha variablat dhe shprehjet paraqesin numra realë.
- Shifrat e dhëna vizatohen në shkallë.
- Të gjitha figurat shtrihen në një nivel/rrafsh.
- Domeni i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është numër real.

REFERENCA



Numri i shkallëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në shkallë të këndeve të trekëndëshit është 180.

Për pyetje me zgjedhje të shumëfishta, zgjidhni çdo detyrë, zgjidhni përgjigjen e saktë nga zgjedhjet e dhëna dhe më pas rrethoni përgjigjen tuaj në këtë libër. Rrethoni vetëm një (1) përgjigje për çdo pyetje. Nëse ndryshoni mendje, fshijeni plotësisht rrethin. Ju nuk do të keni përfitime për pyetjet me më shumë se një përgjigje të rrethuar, ose për pyetjet pa përgjigje të rrethuara.

Për pyetjet e përgjigjeve të prodhuara nga studentët, zgjidhni çdo detyrë dhe shkruani përgjigjen tuaj pranë ose nën pyetjen në librin e testit siç përshkruhet në vijim.

- Pasi të keni shkruar përgjigjen tuaj, rrethoni atë qartë. Ju nuk do të merrni kredi për asgjë të shkruar jashtë rrethit, ose për ndonjë pyetje me më shumë se një përgjigje të rrethuar.
- Nëse gjeni **më shumë se një përgjigje të saktë**, shkruani dhe rrethoni vetëm një përgjigje.
- Përgjigja juaj mund të jetë deri në 5 karaktere për një **përgjigje** pozitive dhe deri në 6 karaktere (përfshirë shenjën negative) për një **përgjigje** negative, por jo më shumë.
- Nëse përgjigja juaj është një **thyes** që është shumë e gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkruani ekuivalentin dhjetor.
- Nëse përgjigja juaj është një **dhjetor** që është shumë i gjatë (mbi 5 karaktere për pozitive, 6 karaktere për negative), shkurtoje atë ose rrumbullakoje në shifrën e katërt.
- Nëse përgjigja juaj është një **numër i përzier** (si p.sh. $3\frac{1}{2}$), shkruajeni atë si një thyesë e parregullt ($7/2$) ose ekuivalentin e saj dhjetor (3.5).
- Mos përfshini **simbolet** të tilla si një shenjë përqindjeje, presje ose shenjë dollari në përgjigjen tuaj të rrethuar.

2.4.2 Gjatë Modullit

Pas 38 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në Modulin 2.

Pas saktësisht 43 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë.

2.4.3 Pas Modulit 2

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Mbylleni librin e testit dhe lëreni në tavolinë.

2.5 Seksioni i SAT Esesë

2.5.1 Para Esesë

Për të lajmëruar pauzën, kujdestari juaj do të thotë:

Vendoseni kalkulatorin nën tavolinë. Tani do të bëjmë një pauzë prej 5 minutave për zgjatje. Nuk duhet të largoheni nga klasa ose diskutoni pyetjet e testit.

5 minuta pauzë

Në fund të pauzës, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutem uluni në vendin tuaj.

2.5.2 Shpërndarja e materialeve të Esesë

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Tani do të ju jap nga një libër të Esesë dhe fletën e përgjigjeve secilit prej juve. Mos e hapni librin e Esesë deri të mos ju them ta bëni këtë.

Kujdestari juaj do të vazhdojë duke thënë:

Kur të merrni librin e Esesë kthejeni përmbys dhe shkruani me shkronja të shtypit mbiemrin, emrin dhe inicialin e mesëm, nëse keni. Pastaj shkruani me shkronja shtypi kodin _____ dhe emrin _____ e kësaj shkolle dhe kodin (ose emrin) e kësaj klase testimi _____, të cilin e kam postuar për ju.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Plotësoni emrin e plotë ligjor tuajin në fushën 1 tani. Përfshini hapësirat, vizat ose apostrofët nëse janë pjesë e emrit tuaj. Në kuti shkruani shkronja të mëdha të shtypit, pastaj mbushni fluskat përkatëse. Sigurohuni që çdo shenjë është e errët dhe e mbush tërësisht fluskën.

Emri i parë i juaj duhet të jetë emri juaj i parë ligjor. Nëse përdorni një emër tuaj të parë të preferuar dhe ju keni një llogari online të College Board, ju mund ta vendosni aty. College Board përdor emrin tuaj ligjor në ditën e testit për ta konfirmuar identitetin tuaj, por ata do ta përdorin emrin tuaj të parë të preferuar në të gjitha komunikimet e tjera me ju.

Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Për fushën 2, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse e vijoni këtë shkollë, shënoni kodin tonë 6-shifror të shkollës _____ në fushën 2 dhe mbushni fluskat përkatëse. Kur të përfundoni ngriteni shikimin lart.

Nëse nuk e vijoni këtë shkollë ose jeni i shkolluar në shtëpi, ngriteni dorën. Do të vij t'ua jap kodin e saktë për ta plotësuar në fushën 2.

Për fushat 3 dhe 4, kujdestari juaj do të thotë:

Nëse vijoni këtë shkollë, plotësoni flluskën për “Yes” në fushën 3 dhe shënioni emrin e shkollës sonë, qytetit dhe shtetit në fushën 4. Nëse nuk e vijoni rregullisht këtë shkollë, mbushni flluskën që vlen për ju në fushën 3 dhe shkruani informatat për shkollën tuaj në fushën 4. Ngriteni dorën nëse nuk jeni të sigurt çfarë të plotësoni.

Për fushën 5, kujdestari juaj do të thotë:

Shikoni tiketën për qasje dhe gjeni Numrin e Regjistrimit tuaj. Shënioni numrin 10-shifror në kutitë për fushën 5 dhe plotësoni flluskat përkatëse.

Për fushën 6, kujdestari juaj do të thotë:

Në fushën 6, shënioni muajin, ditën dhe 2 shifrat e fundit të vitit kur jeni lindur. Filloni me zero nëse e shënioni një numër njëshifror. Mbushni flluskat përkatëse dhe ngriteni shikimin kur të përfundoni.

Për fushën 7, kujdestari juaj do të thotë:

Kur të jeni gati të plotësoni numrin tuaj të letërnjoftimit në fushën 7, ngrini dorën.

Important: Studentët duhet të shkruajnë esetë e tyre në fletën e përgjigjeve. Ju nuk mund të përdorni letër për ushtrime.

Kujdestari juaj do ti jap udhëzime studentëve për regjistrimin e esesë

Tani do të ju jap disa udhëzime për të ju ndihmuar të siguroheni se eseja juaj do të vlerësohet saktë.

- Përdorni faqen planifikuese pa vija për të marrë shënime dhe planifikuar esenë tuaj. Asgjë që shkruani në faqen pa vija nuk do të vlerësohet për pikë.
- Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë tuaj në faqen e parë me vija, që thotë „Begin Your Essay Here” („Filloni Esenë Tuaj Këtu“). Shkruani esenë tuaj në këto faqe me vija dhe brenda margjinave të shënuara.
- Përdorni laps Numër 2. Nëse nuk përdorni laps, ose nëse i leni faqet e zbrazëta, do të vlerësoheni me zero pikë në Ese.
- Eseja juaj duhet të përshtatet për ta zënë faqet e ofruara. Mos shkruani asgjë përtej fjalës “STOP” në faqen e fundit me vija, sepse çfarëdo e shkruar pas kësaj pike nuk do të vlerësohet për pikë.

2.5.3 Koha për Ese

Për të filluar Esenë, kujdestari i juaj do të thotë:

Pasi të fillojmë, do të keni 50 minuta për të punuar në pjesën e Esesë. Do t’i postoj kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit, dhe do t’ju njoftoj kur të kalojë gjysma e kohës së pjesës dhe kur të mbeten edhe 5 minuta. Mbani fletën tuaj të përgjigjeve dhe librin e testit rrafsh në tavolinë.

Ju lutem mos e nënshkruani esenë tuaj ose mos shtoni emrin tuaj në të (p.sh. „punuar nga Filan Fisteku“). Nëse e bëni këtë, kjo mund të vonojë rezultatin e esesë suaj.

Tani lexoni udhëzimet, pastaj kaloni te pyetja për Ese dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 25 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 25 minuta në pjesën e Esesë.

Pas 45 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ju kanë mbetur edhe 5 minuta në pjesën e Esesë.

Pas saktësisht 50 minutave, kujdestari juaj do të thotë:

Ndalni punën dhe lëshoni lapsin poshtë. Mbyllni fletën e përgjigjeve dhe librin e Esesë. Vendosni fletën e përgjigjeve me ballinën lart pranë librit të Esesë.

Për të gjithë studentët, kujdestari juaj do të thotë:

Urime, keni përfunduar testin. Ju lutem qëndroni ulur të qetë derisa unë i mbledh materialet e juaja të Esesë.

Pas mbledhjes së materialeve tuaja, kujdestari juaj do të shkoj përpara te [Para Lirimit](#).

3 Lirimi

Pasi të përfundojë testimi, kujdestari juaj do të thotë:

Urime. Ju e keni përfunduar SAT. Pavarësisht se si ndjeni se shkoi, ju keni arritur shumë vetëm duke qenë këtu sot dhe duke përfunduar testin.

Në vijim, kujdestari juaj do të thotë:

Ju lutemi, uluni në qetësi derisa unë i mbledh dhe i numëroj librat tuaj të testimit.

3.1 Para lirim të studentëve

Pasi të numërohen të gjitha materialet, kujdestari juaj do të thotë:

Mbani mend, duke i dorëzuar përgjigjet tuaja, ju pranoni që të mos merrni asnjë pyetje të testit nga klasa e testimit, t'ia jepni askujt ose t'i diskutoni ato me këdo përmes emailit, mesazheve me tekst, në internet ose në ndonjë mënyrë tjetër. Kjo ndihmon që të gjithë studentët të kenë një përvojë të drejtë dhe të barabartë të testimit. Nëse keni parë diçka sot që ju brengos, ejani dhe flisni me mua para se të largoheni.

Nëse doni ti anuloni rezultatet tuaja, ju lutem më takoni para se të largoheni.

Keni tre ditë për të përditësuar rezultatet tuaja falas dërgoni përzgjedhjen në Bluebook. Nëse dëshironi ta bëni këtë, do t'ju duhet tiketa juaj e qasjes, kështu që mbajeni diku të sigurt. Nëse keni nevojë për ndihmë për të hyrë në Bluebook, ju lutem takoni këshilltarin tuaj.

Siç kam thënë në fillim të testit, nëse një person shkel cilëndo nga politikat që kanë të bëjnë me sigurinë e testit, rezultatet e tyre do të anulohen dhe atyre mund t'u ndalohet pjesëmarrja në testet tjera të College Board në të ardhmen.

Ju lutem pritni në ulësen tuaj derisa të liroj rreshtin tuaj. Në atë pikë, mund të mblidhni gjërat tuaja personale dhe të afroheni për të marrë çfarëdo që keni dorëzuar para testit. Ndërsa largoheni, ju lutem keni konsideratë për të tjerët që janë ende duke punuar në klasat tjera. Sërish, përgëzime për punën tuaj sot.

Kujdestari juaj do ta marr këtë librezë nga ju para se ju të largoheni.